



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:178412

Datë: 02.02.2021

Numri i dokumentit: 01467295

PKR.nr.1020/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Isuf Makolli, me sekretaren juridike Kimete Mehmeti, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. K., i akuzuar për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe të akuzuarve I. K., B. K. dhe S. K., të akuzuar për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/I.nr.524/2017, të datës 01.03.2018, pas shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, të mbajtur më datë 01.02.2021, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Shemsije Asllani, i akuzuari B. K., të njëjtën ditë, me datë 01.02.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. K.**, nga i ati J. dhe nëna Z. e gjinisë D., i lindur më, në fshatin T. Komuna e Malishevës, me vendbanim në Prishtinë-Matiqan rr. "Sh. T." Nr.. , me numër personal të letërnjoftimit .., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punëtor i ndërtimtarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.tel.....

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 07.08.2016, rreth orës 08:45 në shtëpinë e tij në rrugën I. K. në Prishtinë, i pandehuri kishte mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armën e tipit Z.. kal 6.35 mm, me numër serik T.... me një karikator me gjashtë fishek, të cilën armë e ka konfiskuar Policia e Kosovës.

-me këtë ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve:7, 17, 21,41,43,46,73 dhe 374 par.1 të KPRK, si dhe neneve 248 e 365, të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në shumë prej **400 € (katërqind euro)**, të cilin dënim i akuzuari B. K., obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre (3) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nga gjykata, i akuzuari nuk dëshiron ta paguaj ose nuk mundet ta paguaj, gjykata dënimin me gjobë mundet t'ia zëvendësojë në dënim me burg, duke i llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.
- Të akuzuarit B. K., i konfiskohet pistoleta e tipit Z.. kal 6.35 mm, me numër serik T. me një karikator dhe 6 fishek.
- Obligohet i akuzuari B. K., t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumë prej **30 € (tridhjetë euro)**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II

Konform nenit 363 par.1 nen par.1.3 të KPPRK-së, ndaj të akuzuarve:

1. **I. K.**, nga i ati J. dhe nena Z., i lindur me ... në fshatin T. Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. **B. K.**, nga i ati J. dhe nena Z., i lindur me në fshatin T. Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me numër personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës
3. **S. K.** nga i ati J dhe nena Z., i lindur me në fshatin T. Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me numër personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse me datën 07.08.2016, rreth orës 08:00 në rrugën I. K. në Prishtinë pas një mosmarrëveshje të atëçastshme lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët të pandehurit I., B., e S. e kanë goditur me grushta të dëmtuarin –vëllain B. K. neper pjesë të ndryshme te trupit ku me çrast të dëmtuarit i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore,-

Me këtë kishin për të kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nen par.1.4 lidhur me neni 31 të KPRK-së.

- Sepse ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale, me datë 07.08.2020.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- I dëmtuari **B. K.**, nga Prishtina për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civilo juridik

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Renda, me aktakuzën PP/L.nr.524/2017, të datës 01.03.2018, i ka akuzuar Besnik Krasniqi, për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit: I. K., B. K. dhe S. K., të akuzuar për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjyqtarit të çështjes kjo lëndë i është dorëzuar në punë me datë 9.11.2020.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 01.02.2021, ne të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Shemsije Asllani dhe i akuzuari Besnik Krasniqi.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri B. K. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i njëjti shpreh keqardhje dhe pendim për veprimet e tij, e lut gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shtetit Shemsije Asllani, e cila deklaroi se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë konform nenit 248 KPPR dhe është në përputhshmëri me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënon sipas ligjit.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari B. K., ne seancën e shqyrtimit fillestar për kryerjen e veprës penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet nga Prokuroria, dhe mendimit të prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, Gjykata me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që gjykata u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht, pa presion apo ndikim, është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuzën, dhe se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 i KPPR-së për pranimin e fajësisë.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës, por edhe nga deklaratimet e palëve në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit B. K., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së, si dhe vërtetoi gjendjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: intensitetin e rrezikimit apo dëmtimin e vlerës së mbrojtur, pranimin e fajësisë nga i akuzuari, se i njëjti ka shpreh pendim për veprimet e tija, sjelljen e mëparshme të tij, sinqeritetin e treguar gjatë gjykimit, e nga vepra penale nuk ka pasur pasoja, është hera e parë që i akuzuari ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rendues, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK.

Në rastin konkret, gjykata ka marrë në konsideratë se rreziku penal dhe vlera e dëmshme e veprës penale ka qenë relativisht e vogël dhe vepra penale nuk ka rezultuar me dëme të konsiderueshme të vlerës së mbrojtur.

Sa i përket pikës dy të aktakuzës gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se për veprën penale Lëndimi i lehtë trupore nga neni 188 par.1 nen par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën janë akuzuar të pandehurit e lartcekur ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale ndaj të pandehurve I. K. B. K. dhe S. K., sepse vepra penale është kryer me datë 07.08.2016, ndërsa parashkrimi absolut i ndjekjes penale ka arrit me datë 07.08.2020.

Sipas nenit 106, par.1 nën par. 1.6 të KPRK, parashkrimi shkaktohet në afat prej dy (2) vite nga kryerja e veprës penale për të cilën në bazë të KPRK, të pandehurit mund t'i shqiptohet dënim me burgim deri në një (1) vit ose me dënim me gjobë.

E në bazë të nenit 107, par.8, të KPRK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast, kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, respektivisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale, e që në rastin konkret është data 07.08.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e armës së lartcekur dhe fishekëve u muar në bazë të nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 248, 363 e 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky Aktgjykim është përpiluar me datë 02.02.2021.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

PKR.nr.1020/2020, datë 01.02.2021.

**Procesmbajtëse,
Kimete Mehmeti**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Isuf Makolli**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.